

VENDIM
Nr. 1, datë 6.2.2020

**PËR NJË SHITESË NË NORMAT TEKNIKE-PROFESIONALE DHE
METODOLOGJIKE TË SHËRBIMIT ARKIVOR NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 15, të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat” dhe pikës 5/ç, të nenit 8, të VKM-së nr. 360, datë 21.4.2017, “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave”, i ndryshuar, me propozim të Kryetarit, Këshilli i Lartë i Arkivave

VENDOSI:

Në “Normën teknike-profesionale e metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, të bëhet shtesa e mëposhtme:

1. Në fund të nenit 41, shtohen fjalët:

Raftet e lëvizshme, vendosen 10 cm larg murit, me hapësira hapje 80 cm larg nga njëri-tjetri. Rrugicat e qarkullimit kryesor të jenë 100–120 cm. Çdo element i raftit të jetë, jo më shumë se 15 nivele, secili me lartësi 22 cm, thellësi 80 cm (për t’u shfrytëzuar nga të dy anët) dhe me gjatësi 100–120 cm për modul. Niveli i parë dhe i fundit i rafteve të jenë së paku 20 cm mbi dysheme dhe nën tavan. Raftet e lëvizshme duhet të jenë, me akses kontrolli, të mbyllura nga të dyja anët, mbyllje qendrore e secilit sistem nga qendra me sistem elektronik, ruajtje e të dhënave në sistemin elektronik, caktimin e kohës së hapjes dhe mbylljes së sistemit, brava elektronike dhe kontroll i saj.

2. Ngarkohen të gjitha autoritetet publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ardit Bido